

PROPOZIMI I KONJUFÇËS PËR PRESIDENT THELLON PËRPLASJET MES PUSHTETIT, OPOZITËS DHE OSMANIT



Seanca për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, e mbajtur vonë mbrëmjen e djeshme, përfundoi pa rezultat, me vetëm 65 deputetë të pranishëm, 40 minuta para afatit kushtetues. Albulena Haxhiu e Vetëvendosjes shpalli ndërprerjen e seancës për mungesë kuorumi, duke theksuar se nuk mund të vazhdohet pa dy të tretat e deputetëve. Deri më tani ishte propozuar vetëm një kandidat, Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa për thirrjen e seancës nevojitej edhe një kandidat tjetër. Vonë gjatë natës, LV-ja propozoi edhe Fatmire

Kollçakun si kundërkandidate të Konjufcës. Partitë opozitare nuk kanë propozuar emra të tjerë, duke kërkuar marrëveshje politike ose figurë konsensuale, ndërsa LV-ja ka ofruar mbështetje edhe për presidenten aktuale, Vjosa Osmani, e cila ka refuzuar. Vetëvendosje i ka bërë thirrje opozitës të propozojë kandidatin e tyre dhe ka ofruar nënshkrimet e nevojshme të deputetëve për të mundësuar zhvillimin e procesit. Opozita akuzon LV-në dhe Albin Kurtin se po e shtyjnë vendin drejt një krize politike dhe zgjedhjeve të reja.



REPUBLIKA E KOSOVËS, PJESË E OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR KRIMIT KIBERNETIK F. 7

KOSOVA SHËNON 28-VJETORIN E EPOPESË SË UÇK-së: PREKAZI U BË ALTAR I LIRISË F. 3



CILAT SHËRBBIME I EKSPORTOI KOSOVA MË SË SHUMTI? F. 8

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princsha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL

BUNJAKOL

EUROFASADË

BALLKANI, FERIZAJ, DUKAGJINI DHE LLAPI, NË GJYSMËFINALE TË KUPËS SË KOSOVËS F. 11



Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



SENATI BLOKON PROPOZIMIN PËR TA KUFIZUAR AUTORITETIN E TRUMPIT NË LUFTËN NDAJ IRANIT F. 2

OVLUÇK-ja: ËSHTË FYESE QË KATEGORITË E LUFTËS U LANË JASHTË SEANCËS SOLEMNE PËR EPOPENË F. 3

HOTI PRET PËRFAQËSUESIT E KOMF-it, DISKUTUAN PËR ADRESIMIN E SFIDAVE NË FUSHËN E MBROJTJES SË FËMIJËVE F. 6

EKONOMI



AUTORITETI I KONKURRENCËS FILLON MONITORIMIN E TREGUT TË KARBURANTEVE F. 8

SPORT

BALLKANI, FERIZAJ, DUKAGJINI DHE LLAPI, NË GJYSMËFINALE TË KUPËS SË KOSOVËS F. 11



SENATI BLOKON PROPOZIMIN PËR TA KUFIZUAR AUTORITETIN E TRUMPIT NË LUFTËN NDAJ IRANIT



UASHINGTON, 5 MARS - Forcat amerikane dhe ato izraelite kanë vazhduar ta sulmojnë Iranin, ndërsa Senati amerikan e ka hedhur poshtë një propozim që do ta kufizonte autoritetin e presidentit amerikan, Donald Trump, për ta vazhduar aksionin ushtarak kundër shtetit të Lindjes së Mesme pa miratim të Kongresit. Trumpi ka thënë më 4 mars se çdo zyrtar iranian që synon pozitat më të larta për t'i zëvendësuar liderët e vrarë, “do të përfundojë i vdekur”, dhe është zotuar se Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli do ta vazhdojnë fushatën ushtarake kundër Iranit. “Jemi në pozicion shumë të fuqishëm tani, dhe udhëheqja e tyre po largohet shpejt. Secili që dëshiron të bëhet lider, do të përfundojë i vdekur”, ka thënë Trumpi në një takim me liderë të sektorit të teknologjisë në Shtëpinë e Bardhë më 4 mars. “Po ia dalim mirë në frontin e luftës, nëse e them butë këtë. Dikush më ka pyetur se deri në numrin 10 sa do ta vlerësoja? Do të thosha 15”, ka deklaruar Trumpi. Presidenti është zotuar se nuk do të lëshojë pe në fushatën e përbashkët ushtarake me Izraelin, që e ka lënë të vrarë liderin suprem të Iranit, Ali Khamenei dhe shumë zyrtarë të tjerë të sigurisë, ushtrisë dhe politikës. Trumpi ka thënë se arsenalin e raketave balistike të Teheranit “po zhduket me shpejtësi”.

Presidenti amerikan ka thënë se e ka urdhëruar sulmin për t'ia parandaluar këtij shteti krijimin e armës bërthamore, por ka thënë se dëshiron që Teherani të mos ketë as program të raketave balistike, që t'i japë fund dhunës kundër protestuesve anti qeveritarë, mijëra prej të civilëve janë vrarë në një shtypje brutale shtetërore në javët e fundit. Duke tentuar t'i ulë shqetësimet për praninë e trupave ushtarake amerikane në tokën iraniane, Shtëpia e Bardhë ka thënë më 4 mars se angazhimi i trupave tokësore në Iran “nuk është pjesë e operacionit në këtë moment”. Ndërkohë, zyra e kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se dy aleatët kanë shënuar “arritje historike” në luftën e tyre - e cila ka hyrë në ditën e gjashtë - kundër Iranit. Një zëdhënës i tij ka thënë se sulmet ndaj Iranit kanë qenë të domosdoshme pasi Teherani ka qenë duke rindërtuar programin e armëve bërthamore në “bunkerët nëntokësorë” dhe që ka pasur sinjale se ka planifikuar të sulmojë “Izraelin dhe forcat amerikane në rajon” por pa ofruar më shumë hollësi.

Republikanët kundërshtojnë kufizimet për kompetencat e luftës

Një propozim i paraqitur në Senatin amerikan parashihte

që çdo sulm i mëtejshëm ushtarak të autorizohet nga Kongresi. Por, shumica e republikanëve e kundërshtuan atë, duke argumentuar se presidenti, si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura, e ka autoritetin t'i drejtojë operacionet ushtarake. Demokratët thanë se votimi është provë për rendin kushtetues. Senatori nga Nju Jorku, Chuck Schumer, tha se ligjvënësit duhet të vendosin nëse do t'i dërgojnë “bijtë dhe bijat” e amerikanëve në rrezik. Nga ana tjetër, udhëheqës republikanë mbrojtën presidentin Trump. Senatori nga Dakota e Jugut, John Thune, tha se Trump po vepron për t'i mbrojtur forcat amerikane, ndërsa senatori nga Karolina e Jugut, Lindsey Graham, e quajti propozimin jokushtetues.

Trafiku ajror në Lindjen e Mesme vazhdon të jetë i bllokuar

Ndërkohë, trafiku ajror në Lindjen e Mesme vazhdon të jetë i bllokuar teksa Irani vazhdon kundërpërgjigjen duke lëshuar raketa dhe dronë drejt Izraelit dhe vendeve të tjera të rajonit ku gjenden baza ushtarake amerikane. Shumë vende perëndimore po përpiqen t'i evakujnë mijëra shtetas të tyre që kanë mbetur

të bllokuar në rajon pas nisjes së fushatës së gjerë ajrore nga Uashingtoni dhe Tel Avivi më 28 shkurt. Departamenti amerikan i Shtetit tha se fluturimi i parë për evakuimin e shtetasve amerikanë u realizua nga Lindja e Mesme më 5 mars, por nuk dha hollësi të tjera.

NATO-ja dënon Iranin

Aleanca ushtarake e NATO-s dënoi Iranin pasi sistemet e aleancës perëndimore ndaluan një raketë balistike iraniane para se ajo të hynte në hapësirën ajrore të Turqisë. “NATO qëndron në krah të të gjithë aleatëve, përfshirë Turqinë, teksa Irani i vazhdon sulmet pa dallim në gjithë rajonin”, tha zëdhënësja e aleancës, Allison Hart. Ajo shtoi se kapacitetet e parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s mbeten të forta në të gjitha fushat, përfshirë mbrojtjen ajrore dhe atë nga raketat. Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit tha se sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, foli me ministrin e Jashtëm turk, Hakan Fidan, për zhvillimet e fundit në Iran dhe në gjithë Lindjen e Mesme. Sipas tij, Rubio i tha Fidanit se sulmet ndaj territorit sovran të Turqisë janë të papranueshme dhe premtoi mbështetje të plotë nga Shtetet e Bashkuara.

Arabia Saudite rrëzon raketa

Ndërkohë, Saudi Arabia njoftoi në orët e para të 5 marsit se kishte kapur tri raketa lundruese që po niseshin drejt vendit. “Tre raketa lundruese u kapën dhe u shkatërruan jashtë qytetit të Al-Kharj”, njoftoi Ministria saudite e Mbrojtjes në rrjetin X - dikur Twitter. Nuk u raportuan viktima apo dëme.

Fundoset një nëndetëse iraniane

Më herët, shefi i Pentagonit, Pete Hegseth, konfirmoi se një nëndetëse amerikane kishte fundosur një anije luftarake iraniane pranë brigjeve të Shri Lankës. Hegseth e përshkroi sulmin - ku humbën jetën të paktën 87 marinarë dhe dhjetëra të tjerë u plagosën ose u zhdukën - si një “vdekje të heshtur”. Autoritetet e Shri Lankës thanë se 32 marinarë iranianë shpëtuan.

Macron paralajmëron Izraelin

Ndërkohë, Izraeli i rriti sulmet kundër pozicioneve të grupit Hezbollah në Liban, pasi ky i fundit lëshoi raketa drejt veriut të Izraelit. Hezbollahu konsiderohet organizatë terroriste nga SHBA-ja. Presidenti francez Emmanuel Macron tha se i kishte kërkuar kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, të përmbahet nga nisja e një ofensive tokësore në Liban. “Ritheksova nevojën që Hezbollahu t'i ndalë menjëherë sulmet ndaj Izraelit dhe më gjerë. Kjo strategji përshkallëzimi është një gabim i rëndë që rrezikon gjithë rajonin”, shkroi Macron në X. Ai shtoi se i kishte bërë thirrje Netanyahut të respektojë integritetin territorial të Libanit dhe të shmangë një ofensivë tokësore, duke theksuar se është e domosdoshme që palët t'i kthehen marrëveshjes së armëpushimit. Ka raportime se forcat tokësore izraelite mund të kenë kaluar tashmë kufirin me Libanin, megjithëse hollësitë mbeten të paqarta.

KOSOVA SHËNON 28-VJETORIN E EPOPESË SË UÇK-së: PREKAZI U BË ALTAR I LIRISË

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 MARS - Kuvendi i Kosovës dhe qeveria kanë mbajtur të enjten mbledhje solemne për shënimin e 28-vjetorit të Epopesë së UÇK-së. Po në kuadër të programit të manifestimit shtetëror të kësaj dite, është mbajtur edhe manifestimi qendror në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë, ku është bërë rreshtimi i kuadrateve të FSK-së. Në këto organizime drejtuesit e shtetit dhe liderët e opozitës vlerësuan se Epopeja e UÇK-së është e skalitur me emrat e heronjve, dëshmorëve dhe martirëve. Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Epopeja e UÇK-së



është dëshmi se liria fitohet me sakrificë dhe unitet. “Epopeja e marsit të vitit 1998 është dëshmi se liria fitohet me sakrificë, unitet, besim në të drejtën tonë për të jetuar të lirë në vatrat tona shekullore. Sot krenaria jonë nuk qëndron vetëm në të kaluarën, ajo marshon para nesh me uniformë moderne, profesionalizëm të lartë dhe përkushtim të palëkundur ndaj Republikës sonë. FSK-ja është trashëgimtare e denjë e UÇK-së. Ajo bart në zemër idealin e lirisë dhe në duar e mban përgjegjësinë e sigurisë së vendit”, ka thënë Osmani. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka kujtuar sakrificën e familjes Jashari dhe rëndësinë historike të ngjarjeve të marsit të vitit 1998 në Prekaz, duke theksuar se qëndresa e tyre shënoi një kthesë të

rëndësishme për popullin e Kosovës dhe për luftën për liri. Haxhiu gjatë fjalës së saj në seancën solemne të Kuvendit për shënimin e Epopesë së UÇK-së, tha se në marsin e vitit 1998 shtëpia e familjes Adem Jashari ishte një shtëpi e zakonshme, ashtu si shumë të tjera në Kosovë, me një oborr të thjeshtë dhe mure të ndërtuara me mund. Ajo theksoi se familja Jashari mori mbi vete barrën më të rëndë të kohës dhe qëndroi e bashkuar përballë rrezikut. “Në atë shtëpi ishin të gjithë bashkë, krah për krah, të vetëdijshëm për atë që po u vinte. Asnjëri nuk u largua. Sakrifika e tyre mbeti jo vetëm dhimbje, por themel i kujtesës dhe qëndresës sonë”, u shpreh ajo.

E kryeministri Albin Kurti ka



politor e okupator. “Ani se familja Jashari ishte e rrethuar shumëfish nga mijëra forca të armatosura, të pajisura me makineri të rëndë dhe mjete ushtarake moderne të kohës, ata luftuan e qëndruan deri në fund, duke dhënë jetën e tyre për lirinë e të gjithë neve. Për këtë familje kishte kuptim vetëm një gjë: Liria. Sepse, asgjë nuk është e vlefshme sikur ajo”, është shprehur Kurti, duke shtuar se përmes sakrificës së Prekazit janë tejkualuar kufijtë e një ngjarjeje të vetme historike të ndodhur në vendin tonë këtu e 28 vjet më parë. “Ajo tashmë është besë e shpresë për popullin tonë, e pikë referimi për brezat e ardhshëm, si dhe çështje studimi e frymëzimi për studiuesit e akademikët mbarë botës”, ka thënë Kurti. Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se familja Jashari u bë simboli i kombit tonë dhe sakrifika e saj u kthye në liri. “Ata nuk u dorëzuan. Ata nuk u

larguan. Ata qëndruan dhe sakrifikuan gjithçka që ne sot të jetojmë të lirë. Më 5, 6 dhe 7 mars 1998, në Prekaz u mbrojt dinjiteti i popullit tonë”, ka thënë Hamza, duke shtuar se Prekazi nuk ishte vetëm një fshat, ai u bë një altar i lirisë, ndërsa familja Jashari u bë simbol i qëndresës së një populli të tërë. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se në historinë e njerëzimit, si në historinë e kombeve, ka momente kur koha duket sikur ndalet dhe një popull përballet me vetveten. “28 vjet më parë, mes thirrjeve monumentale të brezave nëpër histori, në familjen Jashari, Adem Jashari, Hamëz Jashari, Shaban Jashari dhe 56 anëtarë të familjes, të afërm e bashkëluftëtarë, ranë në altarin e lirisë duke i dhënë vendit jo vetëm një histori sakrifice por dhe një thirrje nacionale për përmbushjen e një rrugëtimi që s’mund të ndalej më”, tha

kryetari i LDK-së. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Epopeja e UÇK-së është e skalitur me emrat e heronjve, dëshmorëve e martirëve tanë, duke theksuar se është kohë që kthen në kujtesën tonë kolektive emrat e atyre që flijuan jetën për liri, invalidëve të luftës, veteranëve dhe të pagjeturve në të gjitha trojet shqiptare. “Në këtë datë të shënuar, kujtojmë komandantin legjendar, Adem Jashari, i cili me tërë familjen i dhanë fundin armikut, duke çuar në vend amanetin e patriotëve të të gjitha kohërave. Lavdi familjes emblematike Jashari, lavdi të rënëve ndër breza dhe luftës së UÇK-së!”, ka thënë Haradinaj. Edhe në komunat e Kosovës dhe në shkolla janë mbajtur aktivitete dhe ligjërata për Epopenë e UÇK-së, ku është folur për vlerat e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificën e atyre që luftuan për lirinë tonë.



OVLUÇK-ja: Është fyese që kategoritë e luftës u lanë jashtë seancës solemne për Epopenë

PRISHTINË, 5 MARS - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka reaguar pas mosftesës së përfaqësuesve të kategorive të dala nga lufta në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës kushtuar Epopeja e UÇK-së. Në reagimin e saj, OVLUÇK-ja e ka cilësuar të papranueshëm

dhe thellësisht fyes faktin që në një seancë përkujtimore për historinë e luftës çlirimtare nuk janë ftuar përfaqësuesit e kategorive të dala nga lufta. Sipas kësaj organizate, pikërisht ata burra dhe gra që morën armët për ta mbrojtur idealin e lirisë dhe që

sakrifikuan gjithçka për shtetin, janë lënë jashtë një ceremonie që i kushtohet historisë dhe sakrificës së tyre. “Është paradoksale të flitet për lavdinë e Ushtria Çlirimtare e Kosovës brenda sallës së Kuvendit, ndërsa jashtë saj të mbeten pikërisht njerëzit që e krijuan atë histori

me gjakun dhe sakrificën e tyre”, thuhet në reagim. OVLUÇK-ja thekson se kategoritë e dala nga lufta nuk kërkojnë privilegje, por respektin institucional që u takon, duke shtuar se historia e luftës çlirimtare nuk mund të kujtohet duke përjashtuar ata që e bënë atë histori.





PROPOZIMI I KONJUFÇËS PËR PRESIDENT THELLON PËRPLASJET MES PUSHTETIT, OPOZITËS DHE OSMANIT

Seanca për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, e mbajtur vonë mbrëmjen e sotme, përfundoi pa rezultat, me vetëm 65 deputetë të pranishëm, 40 minuta para afatit kushtetues. Albulena Haxhiu e Vetëvendosjes shpalli ndërprerjen e seancës për mungesë kuorumi, duke theksuar se nuk mund të vazhdohet pa dy të tretat e deputetëve. Deri më tani ishte propozuar vetëm një kandidat, Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa për thirrjen e seancës nevojitej edhe një kandidat tjetër. Vonë gjatë natës, LV-ja propozoi edhe Fatmire Kollçakun si kundërkandidate të Konjufcës. Partitë opozitare nuk kanë propozuar emra të tjerë, duke kërkuar marrëveshje politike ose figurë konsensuale, ndërsa LV-ja ka ofruar mbështetje edhe për presidenten aktuale, Vjosa Osmani, e cila ka refuzuar. Vetëvendosje i ka bërë thirrje opozitës të propozojë kandidatin e tyre dhe ka ofruar nënshkrimet e nevojshme të deputetëve për të mundësuar zhvillimin e procesit. Opozita akuzon LV-në dhe Albin Kurtin se po e shtyjnë vendin drejt një krize politike dhe zgjedhjeve të reja.

Prishtinë, 5 mars - Në prag të skadimit të afatit për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, më 5 mars, në mesnatë, Lëvizja Vetëvendosje (LV) në pushtet ka dalë zyrtarisht me kandidatin për këtë pozitë, Glauk Konjufcën, aktualisht zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme. Për t'u caktuar seanca e Kuvendit për zgjedhjen e

presidentit nevojitet edhe një kandidat tjetër. "Zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, që erdhën si rezultat i një bllokade mbi dhjetë mujore, përveçse u mbajtën në një afat të afërt kohor, dhanë gjithashtu rezultatin më të qartë në historinë e Kosovës së pasluftës. Qytetarët folën fuqishëm kundër bllokimit të shtetit dhe në favor të

themelimit të institucioneve. Në përputhje me këtë rezultat, pa asnjë vonesë u konstituuan dy institucionet themelore të vendit, Kuvendi dhe Qeveria, ndërsa procesi i radhës që kemi përpara është ai i zgjedhjes së Presidentit. Duke pasur parasysh përcaktimet politike të subjekteve parlamentare, si subjekt fitues, propozuam që vendit t'i

ofrojmë një kandidat konsensual për president. Për këtë arsye, ftuam disa herë radhazi në takim subjektet më të mëdha opozitare, me synimin për të gjetur emra dhe propozime rreth të cilëve do të mund të ndërtonim pajtim për këtë pozitë, për zgjedhjen e së cilës kërkohet pjesëmarrja e të paktën 80 deputetëve në sallë. Pavarësisht insistimit tonë, nga këto subjekte nuk morëm asnjë propozim konkret, ndërsa u refuzuan edhe ofertat tona me emra të caktuar. Subjekti ynë politik është i bindur se në vendin tonë ka shumë emra të denjë për këtë pozitë të rëndësishme shtetërore, rreth të cilëve do të mund të ndërtohej një pajtueshmëri për të ecur përpara. Në këtë fazë, zgjedhjet e reja do të ishin krejtësisht të panevojshme. Në këto rrethana, Lëvizja Vetëvendosje!, pas të gjitha përpjekjeve për të arritur marrëveshje, do të propozojë për kandidat për President ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ish-kryetarin e Kuvendit, deputetin e shtatë legjislaturave dhe njeriun e dytë më të votuar në historinë e Republikës sonë, z. Glauk

Konjufca", është thënë në njoftimin e LV-së.

Vetëvendosje u ka bërë thirrje partive opozitare ta propozojnë kandidatin e tyre, duke ofruar edhe nënshkrimet e nevojshme të deputetëve të saj - 30 sosh - në mënyrë të procesi të shkojë përpara. "Në të njëjtën kohë, i ftojmë edhe njëherë subjektet opozitare që të propozojnë një kandidat. Nëse u nevojiten nënshkrime plotësuese ne ju ndihmojmë nga grupi ynë parlamentar. Jemi të bindur se kjo sfidë është e kalueshme, zgjedhjet janë të evitueshme dhe është plotësisht e mundshme të gjejmë pajtueshmëri për të ecur përpara", është theksuar në njoftimin për medie të LV-së.

Opozita e akuzoi Albin Kurtin dhe Lëvizjen Vetëvendosje se nuk po kërkojnë konsensus për zgjedhjen e presidentit, por po e shtyjnë vendin drejt një krize të re politike dhe rrezikut për zgjedhje të reja.

Kandidaturën nga Vetëvendosja dukej se e priste edhe presidentja aktuale, Vjosa Osmani, e cila edhe herën e parë ishte zgjedhur në një listë të përbashkët me këtë parti. ➔

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, tha se ky subjekt ia ka ofruar mbështetjen për kandidim edhe asaj, përveç Konjufcës, por ajo është demantuar shpejt nga kabineti i Osmanit, i cili tha se kjo është gënjeshtër.

Nagavci u kundërpërgjigj dhe tha se qysh sot ia garanton asaj nënshkrimet e nevojshme të deputetëve të Vetëvendosjes për kandidaturë.

Kurti dhe Konjufca i kërkojnë opozitës kandidaturë të dytë për president

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten se shpreson që do të paraqitet një kandidaturë e dytë për president të Kosovës, në ditën e fundit të afatit kushtetues për ta zgjedhur kreun e ri të shtetit. Këtë deklaratë Kurti e bëri pas mbledhjes solemne të qeverisë, në mëngjesin e 5 marsit, për nder të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Pasdite duhet t’i vazhdojmë përpjekjet që ta zgjedhim presidentin. Urojmë, besojmë, shpresojmë edhe në një kandidaturë të dytë, në mënyrë që ta përmbushim kërkesën kushtetuese për garë”, tha ai.

Konjufca, zëvendëskryeministër aktual dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, tha pas mbledhjes së qeverisë se do të ishte mirë që edhe opozita të dilte me një kundërkandidat. “Partitë politike, PDK-ja [Partia Demokratike e Kosovës] dhe LDK-ja [Lidhja Demokratike e Kosovës], duhet të përcaktohen që, nëse nuk e votojnë Glauk Konjufcën, kë do ta votojnë? Për besë, nëse e propozojnë ndonjë emër, ndoshta edhe unë e votoj”, tha ai. Sipas tij, opozita mund ta propozojë edhe presidenten aktuale, Vjosa Osmani.

Abdixhiku: Nuk i takon opozitës të propozojë kandidatë

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka shprehur bindjen se, pas mesnatës, Kosova do të futet në afatet kushtetuese për zgjedhje të reja, për shkak të asaj që ai e quajti “dështim” të institucioneve për të arritur marrëveshje për pozitën e presidentit.

LV-ja, që tashmë e ka propozuar ministrin e Punëve të Jashtme, Glauk Konjufcën, për këtë pozitë, ka kërkuar që opozita ta propozojë kandidatin tjetër. Kjo kërkesë e LV-së shihet si e paarsyeshme nga kreu i LDK-së. “Kjo s’është rrjedha logjike e procesit. Nuk i takon opozitës të propozojë kandidatë. Kandidati që propozohet, duhet të zgjidhet. Ne kemi dashur dhe kemi pasur kandidat konsensual që përfaqëson së paku dy të tretën e popullsisë. Presidenti s’bëhet me kandidatura të njëanshme”, tha Abdixhiku.

Çfarë parasheh Kushtetuta?

Në nenin e Kushtetutës për zgjedhjen e presidentit thuhet se presidenti i ri duhet të zgjidhet 30 ditë para se të përfundojë mandati i presidentit aktual, që në rrethanat e tanishme është data 5 mars, para se Vjosa Osmani ta mbyllë mandatin më 4 prill.

Ehat Miftaraj, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, tha për Radion Evropa e Lirë se edhe nëse Kosova nuk e zgjedh presidentin deri më 5 mars, vendi nuk do të përballet me zgjedhje. Sipas tij, nëse nuk përmbushet ky afat 30-ditor, bëhet shkelje kushtetuese, por nuk ka pasojë juridike sikurse është shkuarja në zgjedhje.

Miftaraj thotë se nuk ekziston një nen ku mund të bazohej dekreti për shpërndarjen e Kuvendit.

Si reagues partitë e tjera për emrin e Konjufcës?

Nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), partia më e madhe opozitare në vend, deputetja Vlora Çitaku tha se “tashmë është e qartë: Albin Kurti nuk kërkon zgjidhje, por pushtet total”.

Çitaku shkroi në “Facebook” se “në kohën kur Kosova ka nevojë më shumë se kurrë për maturi, unitet dhe përgjegjësi shtetërore, ai me vetëdije po e shtyn vendin drejt një krize të re politike”.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, ka deklaruar se PDK-ja nuk do ta mbështesë kandidaturën e Glauk Konjufcës për president dhe nuk do të marrë pjesë në seancat për zgjedhjen e tij, duke akuzuar mazhorancën për shkelje të rendit kushtetues. “Ne kemi vendosur mos ta mbështesim kandidaturën e Glauk Konjufcës dhe asnjë kandidaturë tjetër partiake. Është qëndrim i qartë, dhe nuk do të marrim pjesë në seanca. Por ajo që po përgatitet është - që mos me u mbajt seancat fare, ashtu si po e kuptoj unë. E kjo është përmbyse e rendit kushtetues. Sepse sot Kuvendi u dashtë me u mbledh, me zgjedh ose mos me zgjedh një president”, tha ai.

Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) shkroi në “Facebook” se “qasja e Lëvizjes Vetëvendosje! nuk reflekton një përpjekje serioze për ndërtimin e këtij konsensusi”. Sipas LDK-së, për shkak të qasjes “së papërgjegjshme politike të VV-së, vendi po shkon drejt kalimit të afateve kushtetuese dhe rrezikon të dërgohet në edhe një palë zgjedhje të reja”.

Pse LV-ja nuk e kandidoi Osmanin?

Kur kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është pyetur nga gazetarët më 2 mars pse nuk po e propozon Osmanin. Ai ka lënë të kuptohet se ajo nuk gëzon mbështetje të gjerë, duke thënë se “ne duhet t’i kemi 80 veta që qëndrojnë në sallë dhe votojnë minimalisht”. “Prioritet absolut e kemi shmangien e zgjedhjeve të reja. Duhet të sigurohemi që jo t’i kemi 80, por 84 apo 85”, tha Kurti.

Emini: Një presidente e pavarur sot mund të bëhet një konkurren e drejtpërdrejtë politike nesër

Donika Emini nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë i ka thënë Radios Evropa e Lirë se Kosova u është qasur vazhdimisht zgjedhjeve presidenciale përmes cikleve të manovrimeve politike, e jo përmes ndërtimit të një konsensusi të mirëfilltë. “Tani Kurti po i përdor numrat për ta arsyetuar vendimin e tij për Osmanin, megjithëse ai njihet për arrogancë ndaj numrave dhe për presion ndaj opozitës. Në këtë kuptim, një mandat i dytë për Osmanin nuk ishte kurrë i garantuar. Pavarësisht vlerësimeve të vazhdueshme të larta në publik, ajo nuk shihej domosdoshmërisht si një kandidatë unifikuese parlamentare. Marrëdhëniet e saj me partitë opozitare kanë qenë të tendosura; madje as baza e saj politike, përfshirë GUXO-n, nuk e ka mbështetur kandidaturën e saj, kryesisht për shkak të përçarjeve me Donika Gërvallën. Legjitimiteti popullor nuk përkthehet automatikisht në aritmetikë parlamentare. Ky është realiteti në Kosovë”. Sipas saj, rol në këtë situatë ka luajtur edhe “profili i fortë dhe i dukshëm ndërkombëtar i Osmanit”. “Në një mjedis politik

ku prestigji i politikës së jashtme ushqen autoritetin e brendshëm, kjo dinamikë është e rëndësishme. Për një kryeministër që ka qeverisur me një shumicë të fortë dhe kontroll të centralizuar politik, të mbetesh në hije në arenën ndërkombëtare nuk është çështje e vogël. Ka pasur gjithashtu momente fërkimi mes dy institucioneve: gjatë fazave të ndjeshme të dialogut të lehtësuar nga BE-ja me Serbinë, rreth aspekteve të Procesit të Berlinit dhe në menaxhimin e marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara”.

Mes të tjerash, ajo beson se “duke pasur parasysh karakterin e fortë politik të Osmanit dhe një shkallë të caktuar paparashikueshmërie, ai skenar paraqet pasiguri afatgjatë për Kurtin: një presidente e pavarur sot mund të bëhet një konkurren e drejtpërdrejtë politike nesër”.

Sa i përket kandidaturës së Konjufcës, Emini beson se ky hap ka kuptim strategjik. “Si figura e dytë më e votuar brenda Vetëvendosjes dhe ish-kryetar i Kuvendit, Konjufca sjell si legjitimitet elektoral, ashtu edhe përvojë institucionale. Në të njëjtën kohë, ai është një nga aleatët politikë më të afërt dhe më të besuar të Kurtit. Ky kombinim - qëndrueshmëri e fortë e brendshme, kredibilitet ndërpartiak dhe besnikëri personale - e bën atë një zgjedhje të parashikueshme dhe të harmonizuar politikisht”.

Prej ditësh në medie janë përmendur emra të ndryshëm si kandidatë të mundshëm, të cilëve më 4 mars u është shtuar edhe ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti.

Një kandidat duhet t’i sigurojë dy të tretat e votave të deputetëve në Kuvendin me 120 karrige, ndërsa kuorumi arrihet me 80 deputetë. Nëse në dy rundet e para një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t’i ketë 61.



Gjyqi i dytë ndaj Thaçit ecën shpejt, Specialja: Prokuroria duhet ta mbyllë rastin deri më 18 mars

HAGË, 5 MARS - Gjykata Speciale ka njoftuar se pas marrjes në pyetje të dëshmitarit Christopher Kelly, ka përfunduar edhe procesi i dëshmisë së dëshmitarëve të Prokurorisë në rastin kundër Hashim Thaçit për aktakuzën e dytë për ndërhyrje në drejtësi. Pas kësaj, gjykata ka përcaktuar afatet e tjera procedurale, duke i kërkuar Prokurorisë të

mbyllë rastin deri më 18 mars. “Pas dëshmisë së dëshmitarit, palët trajtuan çështjet e caktimit të afateve dhe hapat e mëtejshëm në procedurë. Në një urdhër me gojë, Gjykatësi i Vetëm caktoi afatet e mëposhtme, ndër të tjera: ZPS-ja duhet ta mbyllë çështjen e saj deri më 18 mars 2026. Ekipet e Mbrojtjes duhet të paraqesin çdo njoftim të Rregullës 130

(rrëzimin e akuzave) deri më 19 mars 2026. Çdo mocion në mbështetje të njoftimeve të tilla duhet të paraqitet deri më 25 mars 2026. ZPS-ja duhet të paraqesë përgjigjen e saj ndaj çdo mocioni të tillë deri më 1 prill 2026”, thuhet në komunikatë. Seanca e paraparë për 6 mars është shtyrë dhe për të do të njoftohet në ditët në vijim.



HOTI PRET PËRFAQËSUESIT E KOMF-it, DISKUTOHET PËR ADRESIMIN E SFIDAVE NË FUSHËN E MBROJTJES SË FËMIJËVE

PRISHTINË, 5 MARS - Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka pritur në takim njoftues drejtoreshën ekzekutive të KOMF-it, Donjeta Kelmendi, presidenten e KOMF-it, Remzije Krasniqi, anëtarin e Bordit të KOMF-it, Sebahate Hajdini-Beqiri, si dhe Pajtim Zeqiri, anëtar i KOMF-it. Përfaqësuesit e KOMF-it e uruan ministrin Hoti për detyrën, duke theksuar se themelimi i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare është një hap i rëndësishëm dhe i nevojshëm për fushën e mbrojtjes së

fëmijëve dhe shërbimeve sociale në Kosovë. Po ashtu, përfaqësuesit e KOMF-it shprehën kërkesën për procedimin sa më të shpejtë të thirrjes publike për mbështetjen financiare të organizatave ofruese të shërbimeve sociale, në mënyrë që të mos ketë vakum mes kontratave dhe ndërprerje të shërbimeve. Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e konsolidimit të Ministrisë si institucion kyç për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave sociale, si dhe për nevojën e vazhdim të forcimit të iniciativave në



mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe grupeve të tjera në nevojë.

Një nga temat kryesore ishte edhe vazhdimi i konsolidimit të legjislacionit në fushën e

mbrojtjes sociale, ndërsa përfaqësuesit e KOMF-it e vlerësuan si hap të rëndësishëm procedimin e projektligjeve të parapara në planin legjislativ të Ministrisë për këtë vit. Ministri Hoti shprehu vlerësim për rolin dhe kontributin e organizatave joqeveritare në mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për kategoritë e cënueshme. Në takim u riafirmua angazhimi i përbashkët për adresimin e sfidave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera sociale që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e familjes dhe të fëmijëve në Kosovë.

UJËSJELLËSI I KRYEQYTETIT ME KONTRATA PËR SHËRBIME, KONSUMATORËT QË NUK FIRMOSIN SHKYÇEN NGA RRJETI



Prishtinë, 5 mars - Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” ka njoftuar se duke filluar nga java e ardhshme do ta nisë procesin e nënshkrimit të kontratave për shërbimet e ujësjellësit me të gjithë konsumatorët e rrjetit. Sipas ujësjellësit të kryeqytetit, me kontratën e shërbimeve të ujit rregullohen marrëdhëniet juridike ndërmjet palëve kontraktuese, përkatësisht të drejtat dhe

obligimet e ndërsjella. “Kontrata përmban: Të drejtat dhe obligimet e palëve për shërbimet e ofruara; Të drejtat dhe obligimet e konsumatorit; Mënyrën e faturimit për shërbimet e ofruara; Procedurat për ankesa, kërkesa dhe shqetësime të konsumatorëve; Si dhe dispozita të tjera të bazuara në legjislacionin në fuqi. Të gjitha këto do t’i kumtohen drejtpërdrejt konsumatorit

para nënshkrimit obligativ të kontratës për shërbime. Ju lutemi të mos hezitoni nënshkrimin e kontratës për shërbime me KRU Prishtina sh.a., pasi mosnënshkrimi i saj mund të rezultojë në pengesa në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të dyanshme, por do t’i jepet edhe afat ligjor në mos të nënshkrimit të kontratës deri në shkyçje nga shërbimet ujësjellësit”, ka njoftuar KRU “Prishtina”.

Gjykata Administrative hapet më 5 maj

Prishtinë, 5 mars - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në mbledhjen e 363-të, ka marrë vendim që Gjykata Administrative ta fillojë punën nga data 5 maj 2026. Kryesuesi i KGJK-së, Albert Zogaj, ka thënë se kjo datë është brenda afateve ligjore. Gjithashtu, Zogaj ka thënë se

gjatë kësaj periudhe do të ndërmerren veprime për transferim të lëndëve. Në këtë mbledhje është bërë me dije se janë shpallur dy konkurse, i pari më 26 dhjetor 2025, i dyti më 12 shkurt 2026. Gjykata Administrative do të funksionojë si gjykatë e shkallës së parë, me juridiksion në tërë

territorin e Republikës së Kosovës. Kjo gjykatë do të jetë kompetente për shqyrtimin dhe vendosjen e të gjitha konflikteve administrative, përfshirë edhe kontestet që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës në sektorin publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



AIP, pjesë e diskutimeve botërore të politikave digjitale në Mobile World Congress 2026

PRISHTINË, 5 MARS - Në kuadër të Mobile World Congress (MWC) 2026, të organizuar nga GSMA në Barcelonë, më 2, 3 dhe 4 mars u zhvillua edhe Programi Ministror i GSMA, i cili këtë vit shënoi 20-vjetorin e tij si një nga forumet më të rëndësishme të politikëbërjes digjitale, duke mbledhur ministri, autoritete rregullatore dhe liderë të industrisë teknologjike nga mbarë bota për të diskutuar për drejtimin e ardhshëm të ekosistemit digjital. Diskutimet e këtij viti u fokusuan në zhvillimet dhe sfidat kryesore të transformimit

digjital në nivel botëror, duke theksuar nevojën për politika publike të koordinuara që mundësojnë inovacionin teknologjik, ndërkohë që garantojnë besim, siguri dhe mbrojtjen e të drejtave në hapësirën digjitale. Në veçanti u trajtuan çështje që lidhen me: qeverisjen dhe rregullimin e inteligjencës artificiale, forcimin e besimit dhe sigurisë në teknologjitë digjitale, rolin e teknologjisë dhe lidhshmërisë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, sfidat e reja të politikave publike në kontekstin e garës botërore teknologjike dhe transformimit

digjital. Në këto diskutime mori pjesë edhe Agjencia për Informim dhe Privatësi, e përfaqësuar nga komisionerja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dërmaku, së bashku me Liridona Zeqiri-Krasniqi, udhëheqëse e Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në AIP të cilat morën pjesë në sesionet kryesore të Programit Botëror Ministerial të dedikuara për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pjesëmarrja e Agjencisë në një forum të tillë botëror është me rëndësi për forcimin e rolit të



Republikës së Kosovës në diskutimet ndërkombëtare mbi qeverisjen digjitale si dhe për ndjekjen e zhvillimeve më të

fundit në politikat që lidhen me teknologjitë e reja, inteligjencën artificiale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

GLSP-JA KËRKON EMËRIM TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KUVENDIT, JO USHTRUES DETYRE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 MARS - Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka deklaruar se procesi i rregullt i rekrutimit për Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit duhet të përmbyllet me emërim, jo me vazhdim të ushtruesit të detyrës. Në një komunikatë GLSP-ja ka deklaruar se një fenomen i tillë, për të cilin thotë se është i përhapur pothuajse në të gjitha kategoritë dhe institucionet publike, dëmton stabilitetin institucional, zvogëlon llogaridhënien dhe dobëson profesionalizmin e administratës publike. “Shkarkimi i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm ditën e djeshme, i cili njëkohësisht është edhe

njëri nga kandidatët fitues, në vend që të pasohej me emërimin nga procesi i rekrutimit, përbën një praktikë shqetësuese në raport me respektimin e procedurave të rekrutimit në administratën publike. GLPS, përmes iniciativës CorrWatch, ka monitoruar këtë konkurs në të gjitha fazat e tij, që nga shpallja e konkursit e deri te faza e intervistave. Bazuar në monitorimin tonë të drejtpërdrejtë, procesi është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk janë identifikuar shkelje që do të cenonin meritokracinë, profesionalizmin apo ligjshmërinë e procesit”, thuhet tutje në komunikatë. GLPS ka deklaruar se mbetet shqetësues dhe absurd fakti që



janë tejkaluar edhe afatet për mbajtjen e një pozite me ushtrues detyre, duke shkelur Ligjin për Zyrarët Publikë, aq më shumë kur procesi i rekrutimit

për këtë pozitë ka përfunduar me ligjshmëri të plotë. Sipas kësaj organizate, pozita të tilla drejtuese duhet të mbrohen nga çdo ndërhyrje apo tendencë

për politizimin e tyre, dhe çdo hap tjetër përveç emërimit nga procesi tashmë i përfunduar i rekrutimit, përbën shkelje ligjore. “Për fund, GLPS konsideron që Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës do duhej të angazhohej në përfundimin e procedurës së rekrutimit, rrjedhimisht fazës së emërimit, e jo të vazhdimin të një praktike të tillë. Për më tepër, çdo tendencë për të anashkaluar këtë proces të ligjshëm të rekrutimit është e pajustifikueshme dhe në kundërshtim me parimin e meritokracisë, si dhe cenon sigurinë juridike dhe të drejtat e kandidatëve. Mospreferenca ndaj kandidatëve fitues nuk përbën bazë ligjore për anashkalim të procesit të zhvilluar”, theksohet në komunikatën e GLPS-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS, PJESË E OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR KRIMIT KIBERNETIK

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MARS - Një operacion kundër krimit kibernetik, i koordinuar nga EUROPOL, në të cilin kanë marrë pjesë disa shtete të botës, përfshirë Republikën e Kosovës, në vendin tonë ka rezultuar me arrestimin e tre personave. Operacioni në Kosovë është zhvilluar të martën, më 3 mars 2026, nga hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike në Policinë e Kosovës, nën udhëheqjen e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në tri lokacione: Vushtrri, Obiliq dhe Ferizaj. Me urdhër të Prokurorisë Speciale janë ndaluar për 48 orë personat: A. R., A. K. dhe R. H., nën dyshimin për kryerjen e veprave penale “Hyrja e paautorizuar në sistem kom-



pjuterik” dhe “Vjedhja e identitetit dhe kredencialeve”. Sipas hetimeve, të dyshuarit gjatë periudhës 2023-2025, duke shfrytëzuar njohuritë e

tyre teknologjike dhe duke vepruar nën nofka dhe emra të rremë, kanë siguruar në mënyra të kundërligjshme të dhëna personale, financiare

dhe kredenciale. Këto të dhëna më pas janë publikuar në platformën online “LEAK-BASE.IO”, me qëllim shitjen dhe përfitimin material, si

dhe duke u mundësuar personave të paautorizuar përdorimin e tyre për qëllime kriminale. Në cilësinë e provave materiale janë sekuestruar: 3 kompjuterë laptop, 5 shtëpiza kompjuteri, 6 telefona mobilë, 2 pajisje memorizuese. Ky operacion është pjesë e një operacioni ndërkombëtar policor (OP LEAK), i cili është zhvilluar në mënyrë të koordinuar dhe të njëkohshme në këto shtete: ShBA, Britani e Madhe, Australi, Gjermani, Kosovë, Rumani, Poloni, Portugali, Kanada, Malajzi, Greqi, Spanjë, Holandë, Belgjikë. Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës rikonfirmojnë përkushtimin në luftën ndaj krimit kibernetik dhe ngritjes së bashkëpunimit me autoritetet e tjera të sigurisë në nivel ndërkombëtar.

Kusari-Lila zhvillon takim në Toronto për investime dhe partneritete ekonomike

PRISHTINË, 5 MARS - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, gjatë vizitës së saj në Kanada, ka zhvilluar takim në Toronto me dy zëvendës-presidentët e Ontario Chamber of Commerce, organizatë e cila përfaqëson mbi 60 dhoma lokale anëtare në gjithë provincën e Ontarios dhe rreth 60 000 biznese përmes rrjetit të saj.

Në këtë takim me zëvendës-presidentët Loui Di Palma dhe Julie Martini, si dhe me menaxherin e programeve Jason Chang, u diskutua për zhvillimin e sektorit minerar, industrinë e mbrojtjes, zhvillimin dhe potencialin e teknologjisë informative si dhe mundësitë për outsourcing dhe partneritete konkrete ndërmjet bizneseve. Ontario është zemra ekonomike

e Kanadasë, duke gjeneruar rreth 38-40 për qind të PBB-së kombëtare, me një ekonomi që kalon 1 trilion dollarë kanadezë dhe me mbi 16 milionë banorë. Provinca është lidere në prodhim industrial, miniera, teknologji, financë dhe industri të avancuara të mbrojtjes, duke ofruar një ekosistem të fuqishëm për investime dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Në një botë me ndryshime të

mëdha dhe konkurrencë të fortë të shteteve për kapital dhe investime, Kosova synon ta krijojë pozicionin e saj bazuar në aftësitë dhe kreativitetin e të rinjve dhe në potencialin e burimeve natyrore. Ministria Kusari-Lila bëri me dije se në mes të Kosovës dhe Kanadasë tashmë është nënshkruar Marrëveshja për Mbrojtjen e Investimeve të Huaja, ndërsa është në proces




edhe Marrëveshja për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, hapa konkretë që e bëjnë bashkëpunimin ekonomik më të sigurt dhe më tërheqës për investitorët.

CILAT SHËRBIME I EKSPORTOI KOSOVA MË SË SHUMTI?

PRISHTINË, 5 MARS - Instituti GAP ka paraqitur të dhënat lidhur me shërbimet që Kosova ka eksportuar më së shumti. GAP-i thekson se në vitin 2025 eksportet e shërbimeve u dominuan nga aktivitete si shërbimet e udhëtimit, shërbimet e TIK-ut, konsulencë dhe shërbime të transportit. Të dhënat janë paraqitur nga viti 2015, ku eksporti i shërbimeve ishte rreth 951.5 milionë euro. Sipas të dhënave, ka pasur rritje graduale çdo vit deri në 2019 (1.7 miliard euro). Në 2020-n shihet një rënie në rreth 1 miliard euro kryesisht për shkak të pandemisë dhe uljes së udhëtimeve. Pas kësaj,

eksporti është rritur shumë shpejt: 2021: 1.9 miliard euro; 2022: 2.5 miliardë euro; 2023: 3 miliardë euro; 2024: 3.4 miliardë euro; 2025: rreth 3.9 miliardë euro. E në vitin 2025 eksportet e shërbimeve u dominuan nga aktivitete si: Shërbimet e udhëtimit, ku përfshihen shërbimet e ofruara për jorezidentët gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë - në vlerë prej 2.8 miliardë eurosh (+16 % krahasuar me vitin 2024). Shërbimet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ku përfshihen shërbimet e zërit dhe të dhënave (përmes

rrjeteve telefonike, transmetimeve kablore e satelitore dhe platformave elektronike të komunikimit), shërbimet për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve kompjuterike, si dhe shërbimet e agjencive të lajmeve - në vlerë prej 398.2 milionë eurosh (+14 % krahasuar me vitin 2024). Shërbimet e tjera të biznesit, ku përfshihen shërbime si shërbimet hulumtuese dhe zhvillimore, shërbimet e konsulencës profesionale dhe menaxhimit, shërbimet teknike etj., me vlerë prej 272.5 milionë eurosh (+4 % krahasuar me vitin 2024), dhe shërbimet e



transportit, ku përfshihen shërbimet e bartjes së udhëtarëve dhe mallrave dhe të

gjitha shërbimet mbështetëse - në vlerë prej 191.3 milionë eurosh (+30 %).

AUTORITETI I KONKURRENCËS FILLON MONITORIMIN E TREGUT TË KARBURANTEVE

Qendresa RAMA
PRISHTINË, 5 MARS - Autoriteti i Konkurrencës ka njoftuar se ka filluar monitorimin e tregut të karburanteve në Republikën e Kosovës, duke përfshirë tregtimin me shumicë dhe me pakicë, me fokus të veçantë të çmimet e naftës dhe benzinës në pikat e shitjes. Autoriteti i Konkurrencës ka bërë me dije se të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregtimin e karburanteve janë aktualisht nën monitorim. Përmes këtij monitorimi, Autoriteti synon të sigurojë mbrojtje nga marrëveshjet e ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet



ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. “Rikujtojmë se çdo marrëveshje, bashkërendim apo veprim i njëanshëm ndërmjet bizneseve, që ka për qëllim ose efekt rritjen

artificiale të çmimeve, ndarjen e tregut apo kufizimin e konkurrencës, përbën shkelje të rëndë të ligjit dhe është subjekt i sanksioneve ligjore. Në praktikë, çmimet e

karburanteve në tregjet ndërkombëtare përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar faktorë të ndryshëm si oferta dhe kërkesa, kostot e përpunimit, si dhe zhvillimet ekonomike dhe gjeopolitike. Për këtë arsye, pritet që edhe luhatjet e çmimeve në tregun vendor të reflektojnë drejtimin dhe përmasën e ndryshimeve në tregjet ndërkombëtare, duke u bazuar gjithmonë në parimet e transparencës, funksionimit të rregullt të tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve nga çmime të padrejta apo praktika që cenojnë konkurrencën në tregun e karburanteve në Republikën e Kosovës”, thuhet në njoftimin e Autoritetit të Konkurrencës. Autoriteti u bënë thirrje bizneseve të veprojnë në

përputhje me parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme; të shmangin çdo formë të bashkërendimit të çmimeve me operatorë të tjerë; të tregojnë përgjegjësi sociale ndaj qytetarëve dhe konsumatorëve, veçanërisht në këtë periudhë të zhvillimeve ekonomike dhe gjeopolitike. Autoriteti i Konkurrencës thekson se ky proces monitorimi po zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me MINT-in, ATK-në, Doganën dhe mekanizmat e tjerë përgjegjës për zbatimin e ligjit, me qëllim të sigurimit të respektimit të plotë të legjislacionit në fuqi, si dhe të vendimeve dhe rregulloreve të përcaktuara nga institucionet relevante në Republikën e Kosovës.


ZKA-ja auditon efektivitetin e përdorimit të kriterit “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”

PRISHTINË, 5 MARS - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës “Efektiviteti i përdorimit të kriterit Tenderi

Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF) për dhënien e kontratave në prokurimin publik”. Auditimi ka për qëllim të vlerësojë nëse organizatat publike e kanë zbatuar kriterin

TEMF në mënyrë të duhur dhe efektive për ta siguruar vlerën më të mirë për para. Ky kriter synon përzgjedhjen e ofertës që ofron kombinimin optimal ndërmjet cilësisë dhe çmimit/kostos, duke

garantuar përdorim sa më efikas dhe racional të fondeve publike. Subjekt i këtij auditimi janë Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, komuna e Pejës dhe komuna e Suharekës.



LE MONDE: LUFTA, MEKANIZMI I NJË GODITJE EKONOMIKE ËSHTË VËNË NË LËVIZJE

Ndikimi i konfliktit do të varet mbi të gjitha nga kohëzgjatja e tij, por rreziku i stagflacionit po bëhet gjithnjë e më i dukshëm. Por me aq sa shihet nga lufta, mekanizmi i një goditje ekonomike është vënë në lëvizje tashmë



Po sikur konflikti në Iran të zgjasë? Ndërsa ofensiva ushtarake e Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit hynte në ditën e saj të gjashtë, të enjten më 5 mars, kjo pyetje shqetësuese ka filluar të mendojë gjithnjë e më shumë aktorët ekonomikë. Kundërofensiva iraniane, e cila po godet vendet e Gjirit, ka arritur të shqetësojë seriozisht qarkullimin në Ngushticën e Hormuzit, një rrugëkalim jetik global për transportin e naftës dhe gazit. Është ende shumë herët për të folur për një krizë ekonomike, por mekanizmi i një goditjeje energjetike po merr formë, me rrezikun që të shkaktojë efekte të quajtura “stagflacioniste” – një kombinim i inflacionit të lartë dhe stagnacionit ekonomik. Të enjten, më 5 mars, drejtoresha e përgjithshme e Fondi Monetar Ndërkombëtar, Kristalina Georgieva, u shpreh pesimiste, duke vlerësuar se ekonomia botërore është “sërish në provë”. “Ky konflikt, nëse do të zgjaste, do mund të ndikonte qartë në çmimet globale të energjisë, në tregje, në rritjen ekonomike dhe

në inflacion”, theksoi ajo. “Tregjet kanë filluar të mendojnë se kjo situatë mund të zgjasë më shumë nga sa pritej fillimisht”, shprehet Bruno De Moura Fernandes, drejtues i kërkimeve makroekonomike në kompaninë Coface. “Parametri kyç do të jetë kohëzgjatja e konfliktit”, shton Mabrouk Chetouane, drejtor i strategjisë për tregjet në Natixis. “Për momentin kemi të bëjmë me një goditje të përkohshme, jo me një krizë.” Që nga e hëna, 2 mars, indeksi francez CAC 40 ka humbur 4.7%. Në të njëjtën kohë, çmimi i gazit në Evropë është rritur me 50%, ndërsa një fuçi Brent crude është shtrenjtuar me 12%. Dhe që nga fillimi i vitit, rritja e hidrokarbureve është edhe më spektakolare: +35% për naftën dhe +93% për gazin.

Lufta, një goditje më shumë e gazit sesa e naftës

Nga pikëpamja ekonomike, kthesa e këtyre ditëve të para të

luftës erdhi nga dy bombardime, të hënën, që ndalën prodhimin e gazit natyror të lëngshëm (GNL) në Katar. Irani goditi dy pika nevralgjike: impiantin e lëngëzimit të gazit në Ras Laffan Industrial City dhe rezervuarin e ujit të një centrali elektrik në Mesaieed (Oum Saïd), një bazë kyçe e prodhimit të gazit. Të hënën, kompania kombëtare QatarEnergy njoftoi pezullimin e prodhimit të GNL. Pasoja është e madhe: në kushte normale ky aktor është përgjegjës për rreth 20% të prodhimit botëror. Për Evropën, kjo goditje kujton luftën në Ukrainë. Në verën e vitit 2022, ndërprerja e pjesës më të madhe të furnizimit me gaz nga presidenti rus Vladimir Putin shkaktoi një rritje historike të çmimeve, duke e çuar gazin në një kulm prej më shumë se 340 euro për megavat/orë. Kjo ndezi një valë të fortë inflacioni, nga e cila konsumatorët mezi po rimëkëmben katër vjet më vonë. Për momentin, goditja është shumë më e kufizuar. Çmimi i

gazit luhetet rreth 50 euro për megavat/orë, gjashtë herë më i ulët se në verën e vitit 2022, dhe rritja ka zgjatur vetëm tre ditë. Megjithatë, Jack Reid, ekonomist në Oxford Economics, paralajmëron se nëse kriza zgjat, ajo mund të jetë edhe më e rëndë se ajo e Ukrainës: “Eksportet e GNL nga Katar dhe Emiratet e Bashkuara Arabe arrijnë në rreth 120 miliardë metra kub në vit, dhe varen plotësisht nga kalimi përmes Ngushticës së Hormuzit. Kjo është shumë më tepër se eksportet që Rusia ndërpreu në vitin 2022, të cilat ishin rreth 70 miliardë metra kub.” Prandaj, rihapja e Ngushticës së Hormuzit në një afat relativisht të shkurtër është thelbësore. Të mërkurën në mëngjes, më 4 mars, Garda Revolucionare Islamiqe deklaroi se kishte “kontroll të plotë” mbi të. Ndikimi në çmimet e naftës është shumë më i kufizuar. Fuçia e Brent crude u rrit ndjeshëm të hënën, por kjo ishte vetëm rritja e 38-të më e madhe që nga viti 1990. Madje, me rreth 82 dollarë (70 euro) për fuçi, çmimi aktual

mbetet relativisht i ulët. Në vitin 1980, pas Revolucionit Iranian, çmimi i naftës ishte rreth dy herë më i lartë se sot (i korrigjuar me inflacionin). Një nga arsyet e këtij reagimi të kufizuar është se vendet kanë rezerva strategjike të naftës, të cilat mund t'i përdorin në raste krize. Për më tepër, nafta e Lindjes së Mesme mund të shmangë pjesërisht Ngushticën e Hormuzit duke kaluar përmes dy tubacioneve: një që lidh Arabinë Saudite me Detin e Kuq dhe një tjetër që lidh Emiratet e Bashkuara me Oqeanin Indian. Ndërsa për eksportin e gazit nuk ekziston një alternativë e tillë ndaj transportit detar. Në këtë kontekst, shumica e analistëve presin që kriza të zgjasë vetëm disa javë dhe të ketë një ndikim global ekonomik relativisht të kufizuar. Oxford Economics vlerëson se prodhimi i brendshëm bruto botëror mund të bjerë me rreth 0.1 pikë përqindjeje, por gjithçka do të varet nga kohëzgjatja e konfliktit. Megjithatë, pasojat ekonomike nuk do të jenë të njëjta për të gjitha rajonet.



Kina, vendi më i goditur

Kina mund të jetë vendi që do të vuajë më shumë ekonomikisht. Ajo sapo ka humbur pothuajse njëkohësisht dy aleatë të rëndësishëm: Iranin dhe Venezuelën.

“Këto dy vende i shisnin Kinës naftë të lirë, duke përfaqësuar përkatësisht 13% dhe 4% të konsumit të saj, thekson Alicia Garcia-Herrero, kryeekonomiste për Azi-Paqësorin në Natixis. Është një goditje shumë negative.”

Mabrouk Chetouane sheh në këtë edhe një nga arsytet e ndërhyrjes ushtarake të presidentit amerikan Donald Trump në Iran: “Është një mënyrë për të dëmtuar furnizimin energjetik të Kinës.”

Takimi i planifikuar në Pekin mes presidentit kinez Xi Jinping dhe Donald Trump, nga 31 marsi deri më 2 prill, pritët të jetë i tensionuar. Nga ana tjetër, Kina, por edhe pjesa më e madhe e vendeve të Azisë janë shumë të varura nga hidrokarburet që kalojnë nëpër Ngushticën e Hormuzit.

Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, 84% e naftës dhe 83% e GNL-së që kalojnë në këtë ngushticë kanë destinacion Azinë: gjysma shkon drejt Kinës, një e katërta drejt Indisë.

Si pasojë, beteja për furnizimin me energji tashmë ka filluar. Ngarkesa të tëra energjie mund të rishiten edhe kur janë tashmë

në rrugë.

Të mërkurën, anija transportuese e gazit BW Brussels LNG, që vinte nga Nigeria dhe ishte nisur drejt Francës, bëri papritur kthesë dhe tani po kalon nga Kepi i Shpresës së Mirë, në jug të Afrikës, me shumë gjasa drejt Azisë.

Në Evropë: “2026 nuk është 2022”

Në letër, Evropa nuk është shumë e varur nga Ngushtica e Hormuzit, pasi merr vetëm 3% të GNL-së që kalon nga kjo rrugë.

Megjithatë, ndikimi ekonomik përhapet përmes çmimeve. Tregu i gazit është global dhe çdo rajon po lufton për furnizim në një treg tashmë më të kufizuar. Çmimi i gazit në tregun holandez Title Transfer Facility (TTF), që shërben si referencë për Evropën, është rritur me 50% që nga fillimi i luftës në Iran.

Një faktor tjetër shqetësues është se rezervat e gazit në Evropë janë në nivelin më të ulët të dhjetë viteve të fundit për këtë periudhë të vitit, të mbushura vetëm 30%, pas një dimri të ftohtë. “Pasoja kryesore ekonomike do të jetë ndoshta inflacioni më i lartë”, ndoshta rreth 0.3 pikë përqindjeje më shumë, vlerëson në një analizë Capital Economics.

Sipas saj, një rritje prej 10% e çmimit të naftës Brent rrit çmimin e benzinës në pompë me 4% brenda një jave, ndërsa një rritje prej 10% e gazit rrit faturat energjetike të familjeve me 1%

pas tre muajsh.

Vendet më të varura nga gazi dhe me një bazë të fortë industriale, veçanërisht Gjermania dhe Italia, mund të jenë më të goditurat.

“Edhe industritë e varura shumë nga energjia mund të vuajnë”, shton Bruno De Moura Fernandes.

Megjithatë, “2026 nuk është 2022”, thekson François Villeroy de Galhau, guvernatori i Banque de France. Sipas tij, goditja mund të jetë e përkohshme, dhe për momentin rritja e çmimeve është përqendruar kryesisht tek hidrokarburet, ndërsa në fillim të luftës në Ukrainë u rritën pothuajse të gjitha lëndët e para. Evropa ka nxjerrë edhe disa mësim nga ajo krizë. Ndryshe nga viti 2022, centralet bërthamore në France nuk kanë probleme prodhimi dhe vendi aktualisht eksporton energji elektrike, ndërsa Spanja ka zhvilluar ndjeshëm energjinë e rinovueshme dhe është bërë më pak e varur nga gazi.

Shtetet e Bashkuara disi më pak të ekspozuara

Në SHBA, mimi i një galloni benzine është një simbol shumë i ndjeshëm politikisht.

“Është si të prekësh çmimin e bukës në Francë!”, thotë me humor ekonomisti Mabrouk Chetouane. “Ndërkohë ekziston një lidhje shumë e ngushtë midis çmimit të një fuçie naftë dhe çmimit të benzinës në pompë. Nga pikëpamja elektorale,

Donald Trump nuk ka interes që kjo situatë të zgjasë shumë.”

Rickinder Chima, ekonomist në BMI Research, shton se amerikanët në përgjithësi nuk e mbështesin ndërhyrjen ushtarake të SHBA në Iran: 27% e miratojnë dhe 43% e kundërshtojnë.

Kjo, sipas tij, “forcon hipotezën tonë se do të bëhet fjalë për një fushatë ushtarake afatshkurtër”. Megjithatë, edhe pse situata është politikisht shpërthyes, ekonomia amerikane është disi më e mbrojtur nga pasojat ekonomike, sesa Azia apo Europa.

Shtetet e Bashkuara janë një eksportues i madh i gazit natyror të lëngshëm (GNL). Kompanitë që shfrytëzojnë gazin e shistit (shale gas) pritët të përfitojnë shumë nga rritja e çmimeve në tregjet botërore.

Mbi të gjitha, çmimet e brendshme nuk kanë reaguar pothuajse fare ndaj shpërthimit të luftës.

Në fakt, çmimi i gazit në tregun amerikan Henry Hub, që shërben si referencë për SHBA, është rritur vetëm 2%, ndërsa në Evropë çmimet janë rritur me rreth 50%.

Lindja e Mesme e brishtë

Lindja e Mesme, e cila përbën vetëm rreth 2% të PBB-së botërore, po goditet drejtpërdrejt nga kriza.

“Çdo ndërprerje e trafikut në Ngushticën e Hormuzit do të ndikojë menjëherë negativisht në

pjesën më të madhe të të ardhurave nga eksportet dhe në pjesën kryesore të tregtisë së rajonit me Azinë dhe Europën”, vlerëson Ryan Sweet, ekonomist në Oxford Economics.

Ndërkohë, këto vende mbeten shumë të varura nga hidrokarburet, të cilat përbëjnë “nga 40% deri në 50%, madje edhe më shumë, të të ardhurave të këtyre shteteve”, sipas Bruno De Moura Fernandes.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme për diversifikimin e ekonomive të rajonit është turizmi, një sektor që përbënte 10% të PBB-së së Lindjes së Mesme në vitin 2024, por që tani është ndalur papritur. Kompanitë ajrore kanë anuluar shumicën e fluturimeve në rajon dhe shumë udhëtarë që ndodheshin atje janë evakuuar. “Bombardimet në vende turistike do të mbeten gjatë në kujtesën e udhëtarëve të mundshëm”, thotë Ryan Sweet.

Për më tepër, Ngushtica e Hormuzit është një rrugë kryesore edhe për importet ushqimore të vendeve të Gjirit. Sipas Financial Times, Arabia Saudite importon rreth 40% të drithërave dhe farërave vajore përmes porteve të saj.

Ndërsa për Emiratet e Bashkuara Arabe, rreth 90% e lëndëve të para hyjnë në vend përmes portit Jebel Ali në Dubai.

Nëse kalimi i anijeve mbetet i bllokuar për një kohë të gjatë, situata mund të bëhet shumë shpejt e tensionuar.

Éric Albert & Béatrice MADELINE / Le Monde



Dy xhudiste nga Kosova garojnë në Grand Prix Upper Austria

PRISHTINË, 5 MARS - Sot (e premte) dhe deri të dielën në Linz të Austrisë do të zhvillohet gara prestigjioze e xhudos, "Grand Prix Upper

Austria 2026", që do të mbledhë rreth 482 garues nga 59 shtete dhe 6 kontinente të botës. Në "Grand Prix Upper

Austria 2026" Kosova do të përfaqësohet nga Fatjona Kasapi (-52kg) dhe Laura Fazliu (-63kg). Xhudistet do të jetë nën udhëheqjen e

trajneres Majlinda Kelmendi. Fatjona do të ndeshet sot (e premte), ndërsa Laura nesër (e shtunë).



BALLKANI, FERIZAJ, DUKAGJINI DHE LLAPI, NË GJYSMËFINALE TË KUPËS SË KOSOVËS



PRISHTINË, 5 MARS - Ballkani, Ferizaj, Dukagjini dhe Llapi janë skuadrat që e kanë siguruar kalimin në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Në stadiumin e qytetit në Suharekë, Ballkani siguroi kualifikimin në gjysmëfinale

pas fitores 2:1 ndaj Gjilanit në çerekfinale. Bleart Tolaj ka kaluar vendësit në epërsi në minutën 13, ndërsa Gëralb Smajli ka dyfishuar shifrat në minutën 40. Golin e vetëm për Gjilanin e ka realizuar Senad Jarović në minutën 71. Kështu, Ballkani, krahas

luftës për titull, do ta vazhdojë edhe garën për kupë. Fitore në shtëpi ka shënuar edhe Ferizaj, që e ka mposhtur skuadrën e Ligës së Parë, Vushtrinë, me rezultat 2:0. Fitore edhe më bindëse para tifozëve të vet ndaj një skuadre të Ligës së

Parë ka realizuar edhe Dukagjini, i cili ka mposhtur Feronikelin 74 me shifrat 3:0. Një vend në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës ka zënë edhe Llapi, i cili ka mposhtur Malishevën pas penalltive (4:2).

KOSOVA DHE SHQIPËRIA ORGANIZOJNË KAMPIONATIN EVROPIAN U16 NË VOLEJBOLL

PRISHTINË, 21 MARS - Kosova dhe Shqipëria e kanë fituar të drejtën e organizimit të Kampionatit Evropianit 2027 për U16 në volejboll. Lajmi është bërë me dije nga Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK). Sipas FVK-së, vendimi është marrë në mbledhjen e Bordit të Administratës së CEV-it dhe është konfirmuar përmes një letre zyrtare nga presidenti i CEV-it, Roko Sikiriq, drejtuar presidentëve të dy federatave, Bahri Gjinovci dhe Erlind

Pëllumbi. Evropiani do të zhvillohet në verën e vitit 2027 në Prishtinë dhe Tiranë. Finalja do të zhvillohet në Prishtinë. Pjesëmarrëse në këtë ngjarje sportive do të jenë 16 shtete. "Ky vendim i CEV-it vjen edhe si rezultat i organizimit shumë të suksesshëm nga Kosova dhe Shqipëria të Kampionatit Evropian U16 për vajza, i cili u mbajt gjatë verës së vitit 2026 dhe u vlerësua lartë nga institucionet evropiane të volejbollit. Duke

parë këtë bashkëpunim të suksesshëm dhe standardin e lartë organizativ, CEV ka vendosur t'u besojë sërish dy federatave organizimin e një tjetër ngjarjeje të rëndësishme të volejbollit evropian për grupmoshat e reja. Ky kampionat pritet të sjellë në Kosovë dhe Shqipëri talentet më premtues të volejbollit evropian, duke ofruar një skenë të rëndësishme ku yjet e së ardhmes do të kenë mundësinë të shkëlqejnë", ka njoftuar FVK-ja.



BARÇA NË GARË PËR FISNIK ASLLANIN, SULMUESI I KOSOVËS TËRHEQ VËMENDJEN E GJIGANTIT KATALUNAS



HOFFENHEIM, 5 MARS - Tregu i transferimeve në Evropë po nxehet dhe një nga emrat më të përfolur është sulmuesi kosovar 23-vjeçar, Fisnik Asllani i TSG Hoffenheim. Ai ka tërhequr vëmendjen e klubeve të mëdha, përfshirë Barcelonën. Asllani shkëlqeu te SV Elversberg në ligën e dytë

gjermane dhe ka konfirmuar potencialin edhe në Bundesliga. Sulmuesi ka deklaruar se ëndrra e tij është të luajë për Barcelonën dhe pjesëmarrja në Champions League. Gara për firmën e tij është e fortë: Chelsea, Tottenham, Aston Villa, Bayern Munich dhe Borussia

Dortmund e ndjekin nga afër. Hoffenheim i ka zgjatur kontratën deri në 2029, me një klauzolë largimi prej rreth 30 milionë eurosh. Ky sezon, Asllani ka shënuar tetë gola dhe pesë asistime në 25 ndeshje, duke rritur vlerën e tij në treg nga 1.2 në rreth 30 milionë euro, sipas "Transfermarkt".

FShF-ja njofton anulimin e miqësore Shqipëri - ShBA, shkak lufta në Lindjen e Mesme

TIRANË, 5 MARS - Departamenti i Komunikimit në Federatën Shqiptare të Futbollit (FShF) ka bërë me dije se ndeshja miqësore mes ShBA U-21 dhe Shqipërisë U-21, e planifikuar për t'u zhvilluar më 30 mars në Antalia, Turqi,

është anuluar. Federata Amerikane e Futbollit me Federatën Shqiptare të Futbollit, kanë njoftuar se për shkak të situatës së krijuar në Lindjen e Mesme dhe për çështje sigurie, kanë vendosur të mos

udhëtojnë drejt Turqisë, duke e bërë të pamundur zhvillimin e kësaj ndeshjeje miqësore. Ndërkohë, FShF-ja është duke shqyrtuar mundësinë për të gjetur një kundërshtar tjetër për Kombëtaren U-21, për të

zhvilluar një ndeshje miqësore në të njëjtën datë, më 30 mars. Gjithashtu, Shqipëria U-21 ka të programuar të luajë miqësoren e parë në mars ndaj Japonisë U-21 më 27 mars në Antalia.





REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 664-10615
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-1, në sip. prej 188m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Qazim Ibrahim Jasharaj 1/2; Fatmir Munish Jasharaj 1/16; Gazmend Munish Jasharaj 1/16; Shpend Munish Jsharaj 1/16; Elfije Hysen Jasharaj 1/16 dhe Durmish Ramadan Jasharaj 1/4 ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmërisë së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03\L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit që do të përdorën për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër.

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji.

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuar-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuar është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzojë në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkuar
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivët

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj





REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 664-10619
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-3, në sip. prej 12m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Isuf Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmërisë së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03\L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit që do të përdorën për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër.

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji.

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuar-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuar është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzojë në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkuar
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivët

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 464-10625
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-4, në sip. prej 9m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Sami Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmëris së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veqant për vlersimin e pronës së paluajtëshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtëshme Nr.03L-139 me ndryshimt dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03\L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit qe do të përdorën për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës se palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues–Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuës-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pyltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtëshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuës është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtuesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtuesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkuës
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj
pën. 



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 464-10625
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-5, në sip. prej 11m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Avdyl Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmëris së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veqant për vlersimin e pronës së paluajtëshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtëshme Nr.03L-139 me ndryshimt dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03\L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit qe do të përdorën për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës se palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues–Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuës-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pyltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtëshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuës është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtuesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtuesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkuës
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj
pën. 



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 464-10626
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotuesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-6, në sip. prej 11m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Qamil Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmërisë së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluejtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluejtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit që do të përdorën për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluejtshme që shpronësohet dhe dëmeve të kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues–Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluejtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuar-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së paluejtshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuar është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njëjtën ditë në të cilën parashtroesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtroesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkuar
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj






REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 464-10629
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotuesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-7, në sip. prej 21m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Ramiz Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmërisë së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluejtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluejtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit që do të përdorën për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluejtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues–Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluejtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkuar-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së paluejtshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkuar është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njëjtën ditë në të cilën parashtroesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtroesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkuar
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj






REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës
01-Nr. 464-10631
Me datë: 04-03-2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-8, në sip. prej 57m² me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Ibrahim Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmërisë së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

